



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr 1072/Prot.
11

Tirane, më 10.02 2017

MIRATOHET

MINISTRI

Lefter KOKA



KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

HYRJE

Qëllimi dhe përmbajtja e kartës së auditimit të brendshëm

Karta e Auditimit të Brendshëm përcakton statusin organizativ të Njesisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë, autoritetin dhe integritetin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, veprimtaria e të cilave është subjekt i Ligjit për Auditimin e Brendshëm në Shqipëri.

Në respektim të kërkesës të përcaktuar në pika 2.1 "*Karta e auditimit të brendshëm*" të Kapitullit II- të Manualit të Auditimit të Brendshëm, çdo njësi e Auditimit të Brendshëm duhet të ketë Kartën e saj të Auditimit të Brendshëm.

Hartimi i saj është bazuar në:

- ✓ Ligjin nr 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

- ✓ Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdherin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Karta e Auditimit të Brendshëm përfaqeson një nder dokumentet kryesore të Njesise së Auditimit të Brendshëm.

QELLIMI

Qëllimi kryesor i auditit të brendshëm është të japë siguri objektive, të pavarur dhe aktivitet këshillimor, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e subjektit publik. Ai ndihmon subjektin të përmbushë objektivat duke përdorur mënyrën më të mirë sistematike dhe të disiplinuar që ka për qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të rriskut, proceset e kontrollit dhe administrimit.

Auditi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre me anë të analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve e rekomandimeve lidhur me veprimet e ekzaminuara.

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm ka për qëllim:

- ✓ Të ndihmojë subjektet e sektorit publik për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve;
- ✓ Të japë siguri objektive tek organet mbikëqyrëse/titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e menaxhimit;
- ✓ Të ndihmojë menaxhimin e sektorit publik në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e njesisë;
- ✓ Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim; dhe
- ✓ Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontrolleve të vendosura.

MISIONI

Në pajtim me qëllimet e subjektit, misioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është:

- Te jape siguri objektive dhe të pavarur si dhe shërbime konsulence, i krijuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë funksionimin e organizates.
- Te ndihmoje organizaten për të përmbushur objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes.
- Të shtojë vlerën dhe performacën e veprimeve të subjektit, duke siguruar cilësi dhe duke kryer auditime e shërbime këshillimore me kosto të reduktuara
- Të sjellë përfitime në eficensën operationale, kontrole të brendshme të forta dhe politika të përmirësuara.

Për të realizuar këtë mision, auditimi i brendshëm bazohet mbi një strategji të vlerësimit të riskut duke kryer auditime dhe paraqet raporte të pavarura për efektivitetin e kontroleve të menaxhimit dhe performancën operationale të subjektit të audituar.

OBJEKTI I PUNES

Objektivi primar i auditimit të brendshëm është të asistojë menaxhimin e subjektit në realizimin efektiv të përgjegjësiave të tij. Në këtë mënyrë njësia e auditimit të brendshëm i furnizon ato me analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me aktivitetet e shqyrtuara.

Objekti i punës së Auditimit të Brendshëm është që të përcaktojë nëse rrjeti i Njesisë për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes siç janë hartuar dhe paraqitur nga menaxhimi, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë saqë garanton se:

- ✓ risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur.
- ✓ ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes ndodh sipas nevojës dhe me efektivitet:
- ✓ informacioni kryesor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë:
- ✓ veprimet e punonjësve janë në përputhje me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme:
- ✓ burimet sigurohen me ekonomi, përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë të përshtatshme:
- ✓ realizohen programet, planet dhe objektivat:
- ✓ cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm:
- ✓ çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatore që kanë ndikim në njësi janë pranuar dhe adresuar siç duhet.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik synon:

- a) mbështetjen e njësisë publike për të arritur qëllimet e saj, duke:
 - ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike;
 - vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, të strukturave, të vendimeve, të procedurave e të kontrolleve, pra, sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:
 - ↳ identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
 - ↳ përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;
 - ↳ besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
 - ↳ kryerjen e veprimtarive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
 - ↳ ruajtjen e aseteve dhe të informacionit;
 - ↳ përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
 - dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike;

b) mbështetjen e angazhimeve/kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit **për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;**

c) mbështetjen e një angazhimi auditimi për shërbimet e sigurisë, që nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv për të dhënat nga audituesi i brendshëm, me qëllim që ai të japë një opinion ose përfundim të pavarur për një proces, një sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.

Objektivat dhe objektivi për çdo angazhim/detyrë auditimi **për shërbimet e sigurisë** përcaktohet nga drejtuesi i auditimit të brendshëm. Një angazhim/detyrë auditimi kalon nëpër këto faza:

- planifikimin;
- kryerjen e kontrolleve;
- raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra.

Një angazhim/detyrë auditimi **për shërbime konsultimi** ka për qëllim të shtojë vlerën dhe të përmirësojë qeverisjen e njësisë publike, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit, pa qenë e nevojshme që audituesi i brendshëm të marrë përsipër përgjegjësi menaxheriale. Një angazhim auditimi për shërbime konsultimi bëhet me nismën e titullarit të njësisë publike. Objekti dhe objektivat e çdo detyre përcaktohen nga programi i auditimit.

Puna e Auditimit të Brendshëm përfshin dhe drejtimet e mëposhteme:

- Identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe rekomandon për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut;
- Vlerësimin e kontrolleve që trajtojnë riskun;
- Nxitjen e kontrolleve efektive dhe efçente, dhe nismat për përmirësim të vazhdueshëm;

- Vlerësimin dhe pasqyrimin e procesit që siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operaciRekomandimin e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes për:
 - ✓ Promovimin e etikës dhe vlerave të duhura për organizatën;
 - ✓ Sigurimin e menaxhimit efektiv të performancës dhe përgjegjshmërisë së njësisë: dhe
 - ✓ Komunikimin efektiv për risqet dhe kontrollet në fushat përkatëse të njësisë.

NATYRA E AUDITIT TE BRENDSTEM

Auditimi i brendshëm është një funksion i pavarur vlerësimi i krijuar brenda subjektit për të vlerësuar dhe përcaktuar në se:

- Për operacionet e ndryshme dhe sistemet e kontrollit janë ndjekur politika dhe procedura të pranueshme.
- Në se janë pranuar kërkesat legjislative dhe të standarteve të pranuar
- Në se burimet janë përdorur me eficensë dhe ekonomi.
- Në se objektivat e planifikuara janë përmbushur efektivisht
- Në se është përfutur dhe përdorur drejt në vendimarrje informacion financiar I besueshëm

FUSHA E AUDITIT TE BRENDSTEM.

Fusha e zbatimit të veprimtarise së auditimit të brendshëm është :

- ✓ në të gjitha institucionet e sektorit publik, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike (shtetërore) e që, gjatë funksionimit, përdorin fonde nga Buxheti i Shtetit ose nga organizmat ndërkombëtarë, apo fonde të përfituara në formë bashkëfinancimi.
- ✓ ne të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, organet e pushtetit vendor, institucionet e tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike,

institucionet e pavarura e shoqëritë tregtare, apo të çdo forme tjetër, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind.

- ✓ kryerja e auditimit të brendshëm të të gjitha strukturave, programeve, veprimtarive dhe proceseve, si dhe të njësive shpenzuese të nivelit më të ulët brenda njësisë publike, përfshirë edhe auditimin e njësive që shpenzojnë burimet e Bashkimit Europian. Auditimi i brendshëm nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kufizimi brenda subjektit publik të audituar. Shtrirja dhe frekuenca e auditimeve të brendshme do të varet nga rrethana të ndryshme si;
- Rezultatet e audimeve të kryera më parë.
- Risqet relative të lidhura me efektivitetin
- Materialitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit brendshëm
- Burimet në dispozicion të njësisë së auditit brendshëm.

STRUKTURA E AUDITIT TE BRENDSEM

Struktura dhe niveli i tij percaktohen nga menaxhimi, ku kjo strukture duhet te kete si pavaresi funksionale dhe pavaresi organizative.

Pavaresia Funksionale nenkupton qe, struktura e auditimit te jete i pavarur ne planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve dhe rekomandimet e auditimit nga subjekti qe auditohet.

Pavarësia Organizative nenkupton qe, struktura e auditimit eshte pjesë e strukturave të menaxhimit dhe jo e strukturave operacionale të njësisë. Kjo njesi raporton direkt tek titullari i subjektit publik i cili është niveli më i lartë i drejtimit në organizatën që auditohet.

PERGJEGJSHMERIA

Drejtori Ekzekutiv i Auditimit, në përmbushjen e detyrave të veta, është përgjegjës përpara menaxhimit:

- të japë vlerësime vjetore mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në Njësi dhe për objektin e dokumentuar të punës audituese.

- të raportojë rregullisht për dobësitë kryesore të identifikuara nga auditimi, së bashku me rekomandime për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm.
- të informojë periodikisht menaxhimin e lartë mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të departamentit.
- të koordinojë dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e riskut, përputhshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

PAVARESIA

Funksioni i auditit të brendshëm ka status të pavarur brenda subjektit në dhënieve të opinionëve dhe rekomandimeve. Për të realizuar pavarësinë strukturat e auditit të brendshëm duhet:

- Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit.
- Të kryejnë misionin e tij në mënyrë të pavarur që në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve dhe rekomandimet e auditimit nga subjekti që auditohet. Kryerja e auditimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe Standardeve të propozuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit dhe të miratuar nga Ministri i Financave dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë njësisë.
- Të japin gjykime të paaneshme dhe të drejteperdrejta që janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm.
- Të jenë funksionalisht përgjegjës mbi baza të përherëshme.
- Të mos kenë fuqi, pushtet ekzekutiv apo menaxherial, autoritet, funksione apo detyra përveç atyre që lidhen me menaxhimin e funksionit të auditit të brendshëm.

- Të mos jenë përgjegjës për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja por mund të japin këshillime para dhe pas zhvillimeve të tilla.
- Te mos angazhohet në detyra të tjera brenda organizatës të cilat nuk lidhen me funksionimin e Auditimit të Brendshëm. Ato janë pjesë e strukturave të menaxhimit dhe jo e strukturave operacionale të njësisë.

PERGJEGJESIA

Drejtuesi dhe Staf i Njesise se Auditimit te Brendshem kanë këto përgjegjësi:

- të hartojnë një plan vjetor fleksibël për auditimin e brendshëm, duke përdorur metodologjinë adekuate të bazuar në risk, përfshirë çfarëdo shqetësimi për risk ose kontroll të identifikuar nga menaxhimi dhe t'ia dorëzojë këtë plan për t'u pranuar e miratuar nga menaxhimi, Titullari i Institucionit.
- të zbatojë planin vjetor të auditimit siç është miratuar dhe, me kërkesë, edhe ndonjë detyrë ose projekt të posaçëm të kërkuar nga menaxhimi.
- të mbajë staf auditues me nivel profesional dhe me njohuri të mjaftueshme, aftësi, përvojë dhe certifikime profesionale në përmbushje me kërkesat e kësaj Karte.
- të ndërtojë programin e sigurimit të cilësisë me anën e të cilit Drejtuesi i Njesise se Auditimit te Brendshem siguron funksionimin e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.
- të kryejë shërbime konsulence, përtej shërbimeve të Auditimit të Brendshëm për dhënien e sigurisë, të asistojë menaxhimin në arritjen e objektivave.
- të përcaktojë dhe vlerësojë funksionet e rëndësishme të proceseve, operacioneve dhe proceset e kontrollit të brendshëm që janë të reja ose në zhvillim e sipër dhe / ose zgjerimin e tyre.
- përgatitja e raportimeve periodike dhe vjetore për menaxhimin/Titullarin e Institucionit mbi rezultatet e veprimtarisë së auditimit dhe tendencat e lindura si dhe praktikatat e suksesshme në Auditimin e Brendshëm. Raportimi i gjetjeve, përfundimeve dhe rekomandimeve që rezultojnë nga veprimtaritë audituese, si dhe dhënia e informacionit për Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
- të asistojë në investigimin e veprimtarive të rëndësishme brenda njësisë të dyshuara për mashtrim dhe të njoftojë menaxhimin për rezultatet.

- të merret në konsideratë objekti i punës së rregullatorëve dhe audituesve të jashtëm si të shihet e përshtatshme, për qëllim të ofrimit të mbulimit optimal të njësisë me auditim me një kosto të përgjithshme të arsyeshme.

Përgjegjësitë e audituesve janë:

✓ Të njohin, respektojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi dhe me standardet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

✓ Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, me profesionalizëm dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, sipas normave dhe procedurave të veçanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

✓ Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin, të cilat miratohet nga Ministri i Financave, dhe firmosen nga secili auditues;

✓ Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;

✓ Të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me planin vjetor, të miratuar, me përjashtim të rasteve kur janë miratuar ndryshime të parashikuara nga titullari;

✓ T'i propozojnë drejtuesit të njësisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin, deri në shqyrtimin nga organi përkatës, të veprimeve të kundraligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale;

✓ T'i japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve, ekonomike dhe financiare, për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjnë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen;

✓ Të mos bëjnë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajtjnë dokumentet për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;

✓ Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.

Njësitë e auditimit të brendshëm dhe auditet janë përgjegjëse për:

- Zhvillimin dhe implementimin e metodave dhe procedurave të auditit në përputhje me standartet përkatëse.

- Hartimin dhe realizimin e plotë të një programi auditimi për vlerësimin dhe auditimin e veprimtarisë së subjektit në mënyrë të tillë që të mbulohet gjithë fusha e subjektit publik.
- Ekzaminimin e efektivitetit të të gjitha niveleve të menaxhimit në juridiksionin e organizatës dhe pajtueshmërinë e tyre me procedurat dhe politikat e vendosura.
- Rekomandimin për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm me synimin për të ruajtur burimet, për të nxitur dhe inkurajuar performancën e veprimeve të subjektit dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat.
- Rishikimin e procedurave dhe regjistrimeve për rregullsinë e tyre për të përmbushur objektivat e vendosura dhe vlerësimin e politikave e programeve në lidhje me aktivitetin, si funksion i shqyrtimeve të auditit.
- Autorizimin për publikimin e raporteve për rezultatet e ekzaminimeve të auditit duke përfshirë edhe rekomandimet për përmirësim në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit.
- Vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhimi në përgjigje të rekomandimeve dhe dobësive të konstatuara nga auditimi

AUTORITETI

Kryerja e auditimit është subjekt aprovimi nga titullari i subjektit publik dhe drejtuesi I njësisë se auditimit. Titullari i subjektit publik miraton planet vjetore dhe strategjike sipas mënyrave të përcaktuara me ligj dhe akte nenligjore, ndërsa drejtuesi i njësisë së auditit të brendshëm, miraton programet e auditimit të subjektit te audituar të hartuara nga auditet.

Drejtuesi dhe Stafi i Njesise të Auditimit të Brendshëm janë të autorizuar:

- të kenë akses të pakufizuar tek të gjitha funksionet, regjistrat, pronat dhe stafi.
- të shpërndajë burimet, të vendosë frekuencat, të përzgjedhë temat, të përcaktojë objektin e punës dhe të aplikojë teknikat e kërkuara për të realizuar objektivat e auditimit.

- të marrë asistencën e nevojshme të personelit në njësinë ku ata kryejnë auditimet, si dhe shërbime të tjera të specializuara nga brenda njësisë ose jashtë saj.

Auditimi i brendshëm ka autoritetin:

- Të kryeje auditime në pajtim me programin e aprovuar.
- Të ketë akses në të gjitha periudhat e veprimtarisë së subjektit dhe në të gjithë rregjistrat, dokumentat, llogarite, korespondencën, asetet fizike dhe të dhëna të tjera të subjektit që ai i çmon të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit.
- Të kërkojë informacion nga cdo i punësuar i subjektit që auditohet kur gjykohet se një gjë e tillë duhet për të forcuar një opinion mbi ndershmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit.
- Gëzon prioritet nga menaxhimi i të gjitha niveleve për diskutime relevante me çështje që lidhen me auditimin e subjektit.

Drejtuesi dhe Stafi i Njesise të Auditimit të Brendshëm nuk janë të autorizuar:

- të kryejnë ndonjë detyrë operative për organizatën ose partnerët e saj;
- të krijojnë ose miratojnë transaksione të llogarisë që janë jashtë njesise të Auditimit të Brendshëm.
- të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve që nuk janë punësuar nga Njesia e Auditimit të Brendshëm, përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar Audituesit e Brendshëm.

PERGJEGJESITE DHE DETYRAT E MENAXHIMIT

Titullari i Institucionit/ menaxhimi i lartë është përgjegjës për:

- krijimin e shërbimeve të besueshme të auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe garantimin e kapaciteteve të duhura për të përmbushur të gjitha kërkesat që parashikon ligji në fuqi “Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik” dhe përdorimin e tyre me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm apo drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm

në subjektet e audituara, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar;

- ngritjen dhe funksionimin e sistemeve efektive dhe të përshtatshme të menaxhimit financiar e të kontrollit dhe korigjimin e parregullsive të vërejtura nga auditimet e kryera, si dhe marrjen e masave të duhura ligjore, kur kjo është e nevojshme.
- respektimin e kriterëve të marrjes në punë të audituesve, të hartuara në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
- hartimin, implementimin dhe operimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe përgatitjen e politikave dhe procedurave për arritjen e objektivave. Ai duhet t'i japë auditit të brendshëm burimet e nevojshme lidhur me stafin dhe kushtet të tjera të nevojshme për të realizuar auditime të pavarura dhe me cilësi.
- sigurimin e burimeve për trainimin e vazhdueshëm të stafit të auditimit.

INTEGRITETI

Auditimi i brendshëm duhet të adoptojë praktikat më të mira në plaifikimin, kryerjen dhe raportimin e auditimeve. Ai duhet të evidentojë zhvillimet e reja që ndikojnë punën e tyre dhe veprimtarinë e subjektit.

Auditimi i brendshëm është përgjigjës për zbatimin e programit të auditit dhe saktësinë e konkluzioneve, opinioneve dhe rekomandimeve të dhëna.

Auditimi i brendshëm duhet të jetë i ndjeshëm ndaj nevojës për ndryshime dhe duhet të luftojë vetë për kualifikimin e vazhdueshëm të tijë dhe ruajtjen e integritetit në kryerjen e veprimtarive të tijë.

STANDARTET E AUDITIMIT TË BRENDSHEM

Njesia e Auditimit të Brendshëm do të përmbushe dhe të zbatojë:

- Standartet Ndërkombetare mbi “Praktikat Profesionale të Auditimit të Brendshëm” të emetuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IIA).
- Rregullat dhe procedurat për planifikimin, kryerjen, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lena nga auditimi, të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm

- Kërkesat e Kodit të Etikës për auditimin e brendshëm dhe rregullave të sjelljes në administratën publike

DREJTORI

Fran GJINI
Fran GJINI